



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1156/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Makfirete Ademi kandidate për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 2706b pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për kuvend komunal nga KQZ-ja për shkak të parregullsive dhe mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur më 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Makfirete Ademi nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtrri kandidate për kuvendin komunal të Vushtrrise.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Makfirete Ademi kandidate për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e AAK-së me dyshimin se në qendrën e votimit 2706b ka pasur parregullsi nga komisionarët e këtij vendvotimi ku kanë votuar familjarët e saj. Parashtruesi i ankesës kërkon që të vërtetohen këto parregullsi në këtë vendvotim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Makfirete Ademi se ka pasur pa rregullsi në vendvotimin e lartpërmendur, PZAP-i ka konstatuar se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe në

dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë për tu vërtetuar shkeljet e pretenduara dhe se me këtë rast për asnjë moment dhe me asnjë provë nuk ka arritur që ti bëjë të besueshme pretendimet e saja të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1156/2013 më datën 06.12.2016.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.